


MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL



MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Nr. 1849/3 Prot.
Datë 12.3 2020

Nr. 5723/1 Prot.
Datë 1.4 2020

UDHËZIM
Nr. 3/1, datë 12.3.2020

PËR
DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3 DATË 24.2.2020 "PËR KRITERET,
PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIT RURAL".

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 9817, datë 22. 10. 2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të ligjit nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", të pikës 4, të VKM nr. 100, datë 5.2.2020, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2020"

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 3, datë 24.2.2020 "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural", bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun IV, paragrafi i dytë, fjalia "Aplikimet për të gjitha masat do të bëhen nga data 17 mars 2020 deri më 10 prill 2020", zëvendësohet me fjalinë "Aplikimet për të gjitha masat do të bëhen sipas afateve të përcaktuara me Urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas propozimit të AZHBR".
2. Kudo në këtë udhëzim togfjalëshi "data 08.05.2020" zëvendësohet me togfjalëshin "20 ditë pune nga data e përfundimit të aplikimeve".
3. Kudo në këtë udhëzim, me përjashtim të pikës 1, të kreut X, togfjalëshi "data 30.06.2020." zëvendësohen me togfjalëshin "60 ditë pune nga data e përfundimit të aplikimeve".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
BLENDAR ÇUÇI



MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
ANILA DENAJ

